

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Si u bë rrëfimi i Albin Kurtit baza e dënimit për Hashim Thaçin në Hagë?", Lirim Mehmetaj: Dënuan krerët e UÇK-së për rastin e Behajdin Allaqit pa asnjë provë
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/si-u-be-rrrefimi-i-albin-kurtit-baza-e-denimit-per-hashim-thacinn-ne-hage-li-i401849
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:44:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 18:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a338db3bde57a3237b7d11871a5aad7c5a273fe4d8c3c15bfd2b35e53175d087
TEKSTI	4d92b495ff01db2bf06243e8dea63052a07466409ebc37b00e51f7dfd0a14c3b
PAMJA	4cbc915eacc46ae48a418ac9669f4e4884bec4edf28b33e4910705da4393d974

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e5474cce5e8d40901519b09d55d2cc1ba1c00a856ec9717638cd563f33e4a7b7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e5474cce5e8d40901519b09d55d2cc1ba1c00a856ec9717638cd563f33e4a7b7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Rajoni

22 Shtator 2026, 20:33

"Si u bë rrëfimi i Albin Kurtit baza e dënimit për Hashim Thaçin në Hagë?", Lirim Mehmetaj: Dënuan krerët e UÇK-së për rastin e Behajdin Allaqit pa asnjë provë

Shkruar nga Newsbomb



Gazetari Lirim Mehmetaj

Gazetari Lirim Mehmetaj ka publikuar një analizë në Vox Kosova ku hedh dyshime të forta mbi mënyrën se si Gjykata Speciale në Hagë e ka përdorur rastin e Behajdin Allaqit për të dënuar Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin.

Sipas Mehmetajt, në të gjithë aktgjykimin dënues, i vetmi rast konkret i përmendur me emër dhe mbiemër është ai i Behajdin Allaqit, ku pretendohet se Thaçi dhe Veseli e kanë marrë me pranga.

Mehmetaj ngre pyetjen kryesore:

Gjykata jep konstatimin, por nuk tregon asnjë provë mbi të cilën e bazon atë konstatim.

Sipas tij, i gjithë rrëfimi i gjyqtarit Charles Smith për një gjoja konflikt mes Thaçit dhe Allaqit në mbledhjen e LPK-së në Kollatë në vitin 1993, është marrë nga një status në Facebook i Ibrahim Kelmendit.

Mehmetaj sjell dëshminë e Ali Ahmetit, shok i vetë Behajdin Allaqit, i cili ka konfirmuar se në Kollatë nuk ka pasur asnjë mbledhje mesazhesh. Nga ana e gazetarit, konstatimi i kësaj

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

PRANGOSET në Rusi trafikanti i shumëkërkuar i SPAK Shpëtim Aliu, "shoku" i Elidi Dizdanti pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Politikë

"Shteti i gysravel" Sallanji "shpërthen" pas arrestimit të shëfës së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantallonat para kimit (REAGIMI)

Zbulu më shumë artikuj >

ne kurrë nuk ka pasur asnjë përplasje mes tyre. Pra, sipas gazetarit, konflikti vitet 1993 nuk ka ndodhur kurrë dhe është riprodhuar vite më vonë për nevoja politike.

"Në krejt aktgjykimin dënues për Hashim Thaçin dhe të tjerët, paneli i gjyqtarëve përmendi vetëm një rast konkret me emër dhe mbiemër, rastin e Behajdin Allaqit.

Sipas trupit gjykues, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli e kishin marrë me pranga Behajdin Allaqin. Ky është konstatimi i gjykatës. Problemi është se nuk u dhanë provat që e mbështesin këtë konstatim.

Kur një gjyqtar konstaton diçka, fraza pasuese duhet të jetë shpallja e faktit mbi të cilin mbështetet ajo që u tha. Ne e dimë këtë sepse kemi dëshmitarë që e konstatojnë dhe e konfirmojnë, ose kemi dokument, ose kemi provë. Për shembull, paneli konstatoi se zotëri Thaçi dhe Kadri Veseli e morën Behajdin Allaqin me pranga. Por gjykata nuk tregon se në cilën provë bazohet ky konstatim.

Atëherë si u bind gjykata se Thaçi dhe Veseli janë fajtorë për zhdukjen dhe vrasjen e Allaqit? Nuk u bind asnjëherë, por mori një grumbull thashethemesh nga kundërshtarët politikë dhe ndërtoi një skenar trilleri.

Në aktgjykimin që është publikuar, gjyqtari Charles Smith e fillon rastin e Behajdin Allaqit duke thënë se ky i fundit ishte përfshirë në një mosmarrëveshje me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën. E dini ku i kemi dëgjuar këto më parë? Nga shkrime në Facebook, si ai i një personi me emrin Ibrahim Kelmendi. Ai post shkruante: "Në prill 1993 dhe në mbledhjen e katërt të përgjithshme të LPK-së mbajtur në Prishtinë më 26 e 27 korrik 1993. Pikërisht në konsultën e Kollarës ka ndodhur konflikti i parë mes Hashim Thaçit dhe Behajdin Allaqit."

E vërteta është krejt tjetër. Këtë e dëshmon edhe një shok i vetë Behajdin Allaqit, Ali Ahmeti. Në Kollarë nuk ka pasur asnjë përplasje mes Hashim Thaçit dhe Behajdin Allaqit. Pra, përplasia mes Thaçit dhe Allaqit në vitin 1993 nuk ka ndodhur kurrë dhe ishte vetëm riprodhim shumë vite më vonë për nevoja të kohës nga kundërshtarë politikë.

Pjesa tjetër e fjalive të gjyqtarit është kopjim mekanik i shkrimeve në "Bota Sot". Për shembull, ekziston një tekst me titull "Behajdin Allaqin dhe Shaban Shalën i vranë pastaj i zhdukën Thaçi me Kadri Veselin". Dhe në pjesë të tjera, gjyqtarët flasin si dikur kundërshtarët politikë, sikur në një video të Liburn Aliut në Kuvendin e Kosovës.

Në deklaratime si këto shohim kalimin e rrëfimit imagjinar nga gazeta konspiracioniste në institucionalizim, kur përmendet edhe në Kuvendin e Kosovës nga një politikan. Çështja është se prapë këtu nuk jepet asgjë konkrete. "E di ai, e di ky". Është shfrazim që nuk tregon gjë, por ngre dyshimin e kërkuar në atë kohë.

Pastaj vazhdohet: "Heshtja e zëvendëskryeministrit që është president në tentativë e bën shumë të dyshimtë këtë person, i cili ka qenë i fundit me Behajdin Allaqin, por nuk tregon se çfarë ka ndodhur me të" – Albin Kurti në Parlamentin e Kosovës.

Tani disa pyetje për Albin Kurtin dhe Liburn Aliun: Prej kujt dhe nga e kanë informacionin se Behajdin Allaqi për herë të fundit u pa me Hashim Thaçin? Kush ua ka treguar atyre që këta po ua përcjellin qytetarëve? Si është e mundur që bëhen akuza për vrasje në parlament pa kurrfarë nevoje të prezantimit të fakteve dhe dëshmimeve?

Por kjo nuk është pjesa më e çuditshme e deklaratimit të Albin Kurtit në Kuvend. Ai thotë diçka tjetër, të cilën fjalë për fjalë e përsërit edhe gjykata kur i dënoi krerët e UÇK-së. Albin Kurti në fjalimin e tij thotë: "Behajdin Allaqi si kokë intelektuale, politike, kombëtare ishte menjëherë pas Ukshin Hotit dhe dihet që drejtimin e luftës e mbajnë koka të tilla, dhe zëvendëskryeministri që është president në tentativë, ngritjen e tij në karrierë e ka pikërisht duke iu falënderuar devijimeve."

Pra, Albin Kurti i kërkon llogari Hashim Thaçit për Allaqin, sepse sipas Kurtit, Thaçi jo veç që u pa i fundit me të, por edhe përfitoi politikisht nga vrasja e Allaqit. Po gjyqtari çfarë tha? E përbashkëta mes Albin Kurtit dhe Charles Smithit është konstatimi identik ku e bëjnë fajtor Thaçin për një vrasje me qëllim të përfitimit politik, por edhe fakti se as Kurti as Smith nuk japin dëshmi, nuk tregojnë se ku vërtetohet informacioni dhe nuk çajnë kokën për të dhënë prova.

Një tjetër përputhje interesante mes Albin Kurtit dhe Prokurorisë Speciale ndodh edhe në vitin 2023. Në vitin 2023, Albin Kurti befasishëm përkujton në faqen e tij në Facebook një person që kurrë më parë nuk e kishte përkujtuar asnjëherë tjetër, veç në vitin 2023. Kurti përkujton Behajdin Allaqin. "Behajdin Allaqin e zhdukën", shkruante Albin Kurti, i sigurt pasi e informuan se rasti i tij gjendet në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale.

Ideja këtu ishte që rasti i Allaqit të bëhej më i njohur për njerëzit, të flitej më shumë, në mënyrë që kur Specialja t'i akuzojë krerët e UÇK-së në Hagë edhe për të, qytetarët në Kosovë ta dinë më mirë se për çfarë bëhet fjalë. Sepse prokuroria, nga të gjitha rastet e përmendura në aktgjykim, i vetmi rast që referohet me emër ishte ky. Pse? Për t'ia rrënuar figurën Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Pra, për të mbjellë kundër tyre irritimin e nevojshëm që kur të vinin dënimet drakonike, ato të priteshin jo me revoltë, por me heshtje.

Se ky ishte plani, u bë e qartë edhe nga reagimi i mbrojtjes. Avokati i Hashim Thaçit tregoi se gjatë procesit në Hagë, gjykata i kishte urdhëruar që për rastin e Allaqit të mos guxonin të flisnin publikisht, të mos përmendej fare gjatë procesit, derisa vetë në vendim e përmendin. Prandaj Hashim Thaçi ka kërkuar përmes avokatit të tij që të bëhen publike të gjitha gjetjet dhe provat mbi të cilat gjykata ka vendosur.

Prova ka, por për të kundërtën. Madje qysh mot, gruaja e Behajdin Allaqit, Nazmie Allaqi, kishte dëshmuar qysh në vitin 2000, më 29 nëntor, se burri i saj ishte zhdukur dhe se ishte marrë nga forcat serbe në fshatin Drenoc.

Behajdin Allaqi mbetet i zhdukur, por për rastin e tij janë dy pyetje që s'zduken dot më: Si u bë që një gjykatë në zemër të drejtësisë evropiane të dënojë për vrasje pa prova, dhe si ndodhi që Albin Kurti, i cili dikur e akuzonte themelimin e gjykatës për shkak të kompromisit politik, u bë njeriu që dha rrëfimin për dënimin politik të kësaj gjykatë.", thotë gazetari në videon e publikuar.



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





E Mërkurë 18:03 Newsbomb

“Jo në emrin tim!” Shqiptarët mblidhen për të tetën herë në Prishtinë, sonte do të mbahen fjalime nga figura të njohura (EMRAT-DETAJE)



Rajoni

FOTO-LAJM/ Vjosa Osmani takon ish-presidentin Bill Clinton në pritjen e “Clinton Global Initiative”

E Mërkurë 09:39



Rajoni


Kaja Kallas takime “kokë më kokë” me Kurtin e Vuçiç: Normalizimi i marrëdhënieve duhet çuar përpara

E Mërkurë 07:22



E Martë 23:38 Newsbomb

Shqiptarët mbushin Prishtinën prej një jave, Endrit Thaçi del me MESAZH: Shtatë ditë zë, qëndresë dhe vendosmëri (PAMJE)



Rajoni

Autopsia për vrasjen e 25-vjeçares në Greqi, detaje tronditëse: Penelope u vra pas shpine, 15 goditje me thikë

E Martë 21:27



Rajoni

Një javë në shesh për lirin e çlirimtarëve, djali i Hashim Thaçi falenderon publikisht shqiptarët: Ju na motivoni të vazhdojmë betejën ligjore (REAGIMI)

E Martë 18:36 Newsbomb





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.